



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE KURBIN

Nr. 1783 Prot.

Laç, me 28.04.2022

V E N D I M - S H P A L L J E

(Lidhur me ekzekutimin e "Urdherit te Ekzekutimit" te titullit ekzekutiv te debitorit)

Ne Lac, sot me date 28.04.2022

Une, Mikeda Cenaj, me detyre Permbarues Gjyqesor prane Zyres Permbarimore Kurbin , pasi studiova aktet proceduriale te ceshtjes permbarimore Nr. 100/CP0800420220001 rregj. te vitit 2022 bazuar ne Urdherin e ekzekutimit te dates 19.01.2022 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin,

KONSTATOVA:

Se ne date 01.04.2022 eshte depozituar prane Zyres se Permbarimit Kurbin, kerkesa e kreditores Elona Ndue Vocaj ,per venie ne ekzekutim te detyrueshem se bashku me "Urdherin e Ekzekutimit" te Titullit Ekzekutiv (vendim gjyqesor) nr. 74-31 te dt 19.01.2022 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin qe ka marre forme te prere pa u ankimuar me date 21.03.2022, me pale dhe objekt si me poshte:

-Kreditor: Elona Ndue Vocaj

-Debitor: Prend Frang Vocaj

-Me Objekt:Caktimin ne ngarkim te te paditurit Prend Vocaj te detyrimit per ushqim ne shumen 30000(tridhjetemije)leke te reja ne muaj ne favor te femijeve Renato, Françeska dhe Amelia Vocaj. Ky detyrim ne total ne shumen 30000(tridhjetemije)leke, te llogaritet duke filluar nga data e paraqitjes se kerkese padise dt.26.07.2021 dhe te paguhet ne favor te paditeses Elona Vocaj.

Nga ana e zyre tone permbarimore kane filluar procedurat ne baze te nenit 515 e vijues te K.Pr.Civile si dhe ligjit 8730 date 18/01/2001"Per Organizimin dhe Funksonimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqesor"i ndryshuar per ekzekutimin e detyrueshem te Titullit Ekzekutiv te sipercituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jone ne bashkepunim me organet kompetente rezulton se debitori Prend Frang Vocaj nuk merr dijeni per aktet permbarimore nepermjet sherbimit postar pasi rezulton se ky shtetas eshet larguar jashte shtetit sipas shenimit te punonjesit te Postes ne adresen e percaktuar ne gjendjen civile ndersa sipas shkreses zyrtare te Z.GJ.CIVILE eshte banor i kesaj zyre. Ne keto kushte si rezultat i kesaj bazuar ne nenin 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 te K.Pr.Civile lind e nevojshme te procedohet me njoftimin me shpallje publike te debitorit lidhur me detyrimin qe ai ka ndaj pales kreditore Elona Vocaj per detyrimin ushqimor progresiv per tre femijet .

Sa me siper ne mbeshtetje te Nenit 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 te Kodit Procedures Civile, ligjit Nr.8730 date 18/01/2001"Per Organizimin dhe Funksonimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqesor",i ndryshuar

V E N D O S A

1-Te kryej njoftimin nepermjet shpalljes publike me afat 20 (njezet) ditor (duke mare parasysh edhe komunikimin postar) nga data 28/04/2022 - 17/05/2021 te debitorit Prend Fang Vocaj i dtj.03.07.1981 me banim ne Rr.Koceket, Ndr.121, Nr.1, Laç.

2-Ky vendim perpilohet ne disa kopje, ku nje kopje afishohet ne vendbanimin e fundit te pales debitore, nje kopje afishohet ne kendin e njoftimeve te kesaj zyre, nje kopje dergohet per afishim ne ambientet e Bashkise Kurbin/Njesise Administrative perberese , nje kopje dergohet per afishim ne ambientet e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin dhe nje kopje i dergohet per publikim ne faqen zyrtare te Drejtorise se Pergjithshme te Permbarimit Tirane.

3-Kjo shpallje publike ka vleren e aktit te njoftimit per palen debitore Prend Fang Vocaj i dtj.03.07.1981 me banim ne Rr.Koceket, Ndr.121, Nr.1, Laç.

4-Pala debitore Prend Fang Vocaj duhet te paraqitet prane Zyres Permbarimore Kurbin me seli ne Lgj nr.4, Lac ne katin e pare ne ambientet e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin dhe te marre kontakt me permbaruesin gjyqesor te ceshtjes permbarimore per t'ju vene ne dispozicion aktet permbarimore, pasi me kalimin e ketij afati do te vijohet me ekzekutimin e detyruar sipas parashikimeve te nenit 519 e ne vijim te K.Pr.Civile.

U shpall, sot me date 28.04.2022.

**PERMBARUES GJYQESOR
MIKEDA CENAJ**